

---

**REFERATE E KUMTESA**

---

**LEDIA DUSHKU****KRYENGRITJA SHQIPTARE ANTIOSMANE E VITIT 1911  
DHE DUALIZMI I POLITIKËS GREKE\***

Vendosja e Kushtetutës Osmane në korrik të vitit 1908 nuk i fashiti problemet kombëtare në Perandorinë Osmane. Pas shtypjes së puçit të prillit 1909, në të cilin “të shtypurit” luajtën një rol të dorës së parë, Turqit e Rinj vendosën të vinin në jetë pikëpamjen e tyre centralizuese të bashkimit, sipas së cilës në shtetin osman nuk duhej të kishte turq, shqiptarë, grekë, armenë, arabë, por vetëm qytetarë osmanë të bashkuar, të barabartë përpara ligjit, me të njëjtat të drejta dhe detyra<sup>1</sup>. Në gusht 1909 doli ligji mbi shoqatat, zbatimi i të cilit shpërndau shoqatat kulturore dhe mbylli klubet patriotike. Shpërbërja e çetave në territoret shqiptare dhe ato maqedonase do të bëhej nëpërmjet vënies në jetë të ligjit mbi ndalimin e çetave në Rumeli dhe ligjit mbi komitet. Parashikohej kryerja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak edhe për popullsinë jo myslimane. Turqit e Rinj menduan të centralizonin edhe sistemin arsimor në Perandori. Pasi dështuan të devijonin ecurinë e arsimit kombëtar, ata vendosën ta asgjësonin krejtësisht atë. U krijua një inspektorat për shkollat jo turke dhe u kërkua të vendosej me detyrim nëpër shkolla dhe gjykata gjuha turke si gjuhë zyrtare. Gjatë vitit 1910, shkollat shqipe kudo në vilajetet shqiptare u mbyllën duke përfshirë edhe shkollën Normale të Elbasanit. Gazetat shqiptare u ndaluan dhe botuesit në shumë raste u burgosën pa gjyq. Qindra nacionalistë shqiptarë u arrestuan ose u detyruan të kërkonin strehim jashtë vendit<sup>2</sup>.

---

\* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore me temë “100 vjet nga Kryengritja e Malësisë së Madhe, 1911-2011”, organizuar në Tuz (Mali i Zi), më 4-5 prill 2011.

<sup>1</sup> *Historia e Perandorisë Osmane* nën drejtimin e Robert Mantran, Tiranë: “Dituria”, 2004, f. 551-552.

<sup>2</sup> Joseph Swire, *Shqipëria ngritja e një Mbretërie*, Tiranë: “Dituria”, 2005, f. 94.

Por, politika centralizuese e Turqve të Rinj nuk i përgjigjej përfytyrimit që popujt dhe kombet e Perandorisë kishin për bashkimin osman. Bashkimi për ta do të thoshte ruajtje dhe pse jo lulëzim i sistemit të autonomisë kulturore, në përputhje me të cilën, ata do të vazhdonin të ishin në radhë të parë shqiptarë, grekë apo armenë dhe më pas osmanë<sup>3</sup>. Elita e tyre politike kërkonte të kishte më tepër autonomi, shumë prej të cilëve nënkuptonin dhe ëndërronin pavarësinë. Pjesa tjetër e popullsisë shihte rastin që të ruante dhe të forconte traditat ekzistuese.

Për rrjedhojë, përpjekjet centralizuese të Turqve të Rinj shkaktuan zhgënjim e pakënaqësi sidomos tek shqiptarët, grekët e armenët. Një pjesë e tyre u zhgënjye sepse Kushtetuta nuk u sollli lirinë e shpresuar, mirëqenien materiale dhe zhvillimin e lirë kombëtar, të tjerët sepse nuk mundën të ruanin privilegjet dhe të drejtat e kamotshme. Por, të gjithë bashkoheshin në një pikë: regjimi i ri nuk u kishte sjellë dhe nuk do t'u sillte asgjë të mirë.

Në këtë situatë, shqiptarët kundërshtuan përpjekjet e qeverisë për të vendosur taksa, për të ngritur shkolla turke, për të përdorur gjuhën turke në administratë dhe alfabetin arab për të shkruar shqipen. Ligji për ndalimin e çetave që urdhëronte çarmatosjen e popullsisë civile u ndje së tepërmi prej tyre. Brutaliteti me të cilin u krye aksioni gjithnjë e më shumë zbehu besnikërinë e shqiptarëve ndaj Portës, besnikëri prej së cilës varej në shkallë të gjerë ekzistenca e Turqisë evropiane<sup>4</sup>. Edhe shqiptarët katolikë ishin të pakënaqur pasi detyroheshin të shërbenin në ushtrinë e sulltanit dhe të mos kishin më venome. Ndërkaq në vitin 1910, ligji për kishat shqetësoi popullsinë e krishterë që varej nga Patrikana. Funksionimi i pakëndshëm i Parlamentit Osman dhe format e dhunës ekstreme që ushtria osmane përdori pothuajse në të gjitha viset shqiptare deri në Elbasan duke shkatërruar e shfarosur gjithçka, ishin shtysat e fundit që i dhanë jetë Kryengritjes së vitit 1911, tashmë jo në Kosovë si një vit më parë por, në Malësinë e Mbishkodrës.

Thellimi i hendekut, si kurrë më parë, mes shqiptarëve dhe Turqve të Rinj shtronte nevojën e aleatëve. Elita politike shqiptare e kishte të qartë se e vetme kundër osmanëve ishte e pafuqishme. Pasojat e përbashkëta të

<sup>3</sup> *Historia e Perandorisë Osmane...*, f. 551-552.

<sup>4</sup> *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-VI-39, viti 1911, fl. 17-20, Raport i legatës së Britanisë së Madhe në Vjenë për ministrin e Jashtëm, Vjenë, 8 qershor 1911.

politikës centralizuese osmane ishin një premisë e mirë që popujt e kombet në Perandori të ishin bashkë për ta kundërshtuar atë.

Për një sërë arsyesh, Greqia ishte e ndjeshme ndaj kryengritjes në viset veriore.

Në planin e luftës antiosmane, ajo nuk e kishte anashkaluar asnjëherë faktorin shqiptar. Mbretëria Greke edhe pse kishte fituar pavarësinë, e konsideronte të pazgjidhur çështjen e saj kombëtare. Me një sipërfaqe prej 50.000 km<sup>2</sup> dhe popullsi afërsisht 2 milion banorë, ajo pretendonte se rreth 4 milionë grekë të tjerë, pjesë e popullsisë së Perandorisë Osmane<sup>5</sup> duhej t'i bashkëngjiteshin "trungut amë". Ndonëse zyrtarisht, Greqia orvatej të mbante një relacion konkret dhe të mirë me shtetin osman<sup>6</sup>, çfarëdo komplikacioni në Ballkan i jepte shpresë asaj, në vetvete të pa zonjën për të peshkuar në ujëra të turbullta. Për sa kohë shteti grek ishte i dobët ekonomikisht dhe ushtarakisht e në marrëdhënie jo të paqta me fqinjët dhe Fuqitë e Mëdha të bindura për ruajtjen e status-kuosë, Greqia druante të shfaqej aktive në çështjet ballkanike. Ajo përpiqej ta shfrytëzonte me çdo mjet situatën e krijuar nga kryengritja e malësorëve shqiptarë për të siguruar ndërhyrjen e Evropës, ndërhyrje kjo, që do të sillte hapjen e diskutimeve për çështjet e pazgjidhura në Perandorinë Osmane, dy ndër të cilat, ajo kretase dhe maqedonase konsideroheshin primare dhe tejet të vështira për politikën greke. Kjo situatë e bënte Athinën zyrtare sa të kujdesshme aq edhe të interesuar për të shfrytëzuar përpjekjet e shqiptarëve duke shpresuar "t'i nxirrte gështenjat me duart e tyre". Në rast se lëvizja e malësorëve në Veri nuk mbetej e lokalizuar, por hapte siparin e një lëvizjeje të gjerë ballkanike, Greqisë i nevojitej forca e shqiptarëve, të cilët luanin një rol të rëndësishëm në ushtrinë osmane dhe shquheshin për karakterin e tyre luftarak dhe kurajoz<sup>7</sup>.

Nga ana tjetër, Kryengritja Shqiptare mund të kishte konsekuenca fatale për shtetin osman pasi ajo mund të shërbente si katalizator edhe për lëvizje të tjera në Maqedoni, territoret arabe, etj. Administrimi i

---

<sup>5</sup> George B. Leon, *Greece and the Great Power, 1914-1917*, Thessalonica: Institute for Balkan Studies, 1974, f. 1.

<sup>6</sup> *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSSt.A.P.A.A.*), në *AIH*, Vj. 21-3-322, Raport politik i ministrit të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 1 prill 1911.

<sup>7</sup> *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 1501/3, viti (më tej: V.) 1912, dosja (më tej: D.) 24, fl. 7-8. Raport i Konsullatës italiane në Janinë për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë, Janinë, 3 maj 1909.

kryengritjes dhe veçanërisht çarmatimi i shqiptarëve nga ushtria osmane, vlerësohej një punë e vështirë dhe e gjatë. Ajo lypte përdorimin e një ushtrie të madhe, madje mund edhe të paralizonte riorganizimin e ushtrisë osmane, gjë që mund të influenconte në aspiratat latente të popujve e shteteve ballkanike<sup>8</sup>. Perandoria Osmane gjendej në një situatë të vështirë. Nëse ajo i zhvendoste ushtarët nga krahinat e tjera të shtetit për t'i përdorur në lufta të gjata e të rrezikshme me shqiptarët, ruajtja e *status-quo-së* ishte e kërcënuar dhe aspiratat e dremitura nacionaliste të shteteve në Ballkan do të rizgjoheshin. Zhvillimi i Kryengritjes, vështirësitë që ajo i krijonte Portës dhe përfshirja e Malit të Zi, natyrshëm i joshnin shtetet ballkanike, të cilat ishin duke menduar sesi mund të nxirrnin përfundime nga panorama e re dhe interesante që po ndodhte në kufijtë e tyre. Përhapja e shpejtë e Kryengritjes në mënyrë të pashmangshme do të sillte një përplasje të mundshme të shqiptarëve e malazezëve me ushtrinë osmane, në të cilin sigurisht që ata do ta kishin të vështirë të qëndronin indiferentë. Po ashtu, kryengritja shqiptare ishte një zhvillim i pëlqyeshëm për Greqinë edhe për faktin se reagimi i shqiptarëve do të angazhonte forcat ushtarake osmane në Veri, duke i dhënë dorë asaj për të zbatuar më me lehtësi politikën e helenizimit të shqiptarëve ortodoksë në vilajetin e Janinës, popullsi kjo e pretenduar si greke nga zyrtarët e Athinës.

Në orientimin e politikës greke ndaj Kryengritjes dhe marrëdhënieve me shqiptarët një ndikim pati edhe politika italiane. E interesuar për Ballkanin që në vitin 1876, Italia synonte të depërtonte paqësisht në viset shqiptare. Lidhjet historike që ekzistonin midis Romës dhe komunitetit arbëresh në Italinë e Jugut, anëtarët e të cilit mbështesnin sigurimin e autonomisë për territoret shqiptare, sipas vezirit osman, Mehmet Ferid pashës, shprehnin qartë synimet e Italisë. Sipas një vlerësimi të përgjithshëm, bërë prej tij në maj të vitit 1906, "Italia ishte e vendosur të forconte dhe të shtrinte ndikimin e saj në viset shqiptare, duke synuar ta kthente detin Adriatik në një liqen italian"<sup>9</sup>. Preokupimi i shtypit dhe i politikës italiane që i lartë në kohën e Kryengritjes Shqiptare. Gjithnjë e më shumë në rrethet e politikës ndërkombëtare ishte përforcuar mendimi

<sup>8</sup> *HHSSt.A.P.A.A.*, në *AIH*, Vj. 20-14-1480, Shkresë private e ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, Erental për ministrin në Stamboll, Vjenë, 28 prill 1910.

<sup>9</sup> George Gawrich, *Gjysmëhëna dhe Shqiponja, Sundimi otoman, Islamizmi dhe Shqiptarët, 1874-1913*, Tiranë: "Bota Shqiptare", 2007, f. 197.

se Italia merrte pjesë aktive në përgatitjet për një kryengritje të përgjithshme në Shqipëri, madje edhe një pjesë e konsiderueshme e kontrabandës së armëve bëhej me ndërmjetësinë e zyrave konsullore italiane në qytetet bregdetare të Adriatikut<sup>10</sup>.

Zhvillimet e mësipërme binin ndesh me interesat dhe punën e kahershme që Greqia bënte në Shqipërinë e Poshtme. Që në vitin 1904, nënkonsulli grek në Durrës vinte në dukje pengesat e padurueshme që sillte propaganda italiane, e cila punonte hapur kundër Greqisë<sup>11</sup>. Shqetësimi shprehej dukshëm jo vetëm prej terrenit, por edhe në rrethet e politikës së lartë greke. Në pranverë të vitit 1907, kryeministri grek i bënte me dije ministrin të Austro-Hungarisë në Athinë, merakun e qeverisë së tij, në lidhje me planet e Italisë, të cilat shkonin larg në Epir<sup>12</sup>. Krijimi në Romë, në prill të vitit 1911 i Komitetit “Pro Albania”, thirrjet e tij për mbledhjen e fondeve dhe për grumbullimin e vullnetarëve në ndihmë të vëllezërve të tyre shqiptarë si dhe simpatitë e treguara nga shtypi italian në favor të kryengritësve<sup>13</sup>, ishin kambana alarmi për rrethet politike greke.

Për të gjitha sa më sipër, politika greke karshi çështjes shqiptare mori karakter të dyfishtë: paqësor dhe të armatosur. Tek e para përfshihej çdo veprim politik që prirej ta kanalizonte çështjen shqiptare drejt një shteti dualist shqiptaro-grek. Në funksion të këtij qëllimi pretendohesh të ndihmohej për emancipimin shpirtëror të shqiptarëve, duke synuar shkëputjen e tyre nga ndikimi italian e ai austro-hungarez. E dyta, i

<sup>10</sup> *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 21-8-897, Raport i konsullit të Austro-Hungarisë në Manastir për ministrin e Jashtëm, Manastir, 27 shkurt 1911; *Po aty*, Vj. 21-13-1304, Raport i zëvendëskonsullit të Austro-Hungarisë në Vlorë për ministrin e Jashtëm, Vlorë, 19 prill 1911.

<sup>11</sup> Ελευθερία Ι. Νικολαΐδου, *Ξένες προπαγάνδες και έθνική αλβανική κίνηση στις μιτρολιτικές επαρχίες Δυρραχίου και Βελεγράδων κατά τα τέλη του 19ου και αρχές του 20ου αιώνα*, Ιωάννινα: 1978 (Shfrytëzuar materiali në: *AIH*, A-IV-422, fl. 92, E. Nikolaidhu, *Propagandat e huaja dhe LKSH në krahinën metropolitane të Durrësit dhe të Beratit në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX*, Janinë, 1978).

<sup>12</sup> *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 17-2-275, Raport i ministrin të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Jashtëm, Athinë, 31 mars 1907.

<sup>13</sup> *Po aty*, Vj. 21-15-1544, Letër e presidentit të komitetit qendror italo-shqiptar, Francesko Mauro drejtuar një bashkatdhetari (nuk e jep emrin), Napoli: 28 prill 1911; *Po aty*, Vj. 21-4-416, Telegram i konsullit të Austro-Hungarisë në Bari për Ministrinë e Jashtëm, Bari, 4 maj 1911 (Njofton mbi aktivitetet e komitetit “Pro Albania”).

referohej forcimit dhe përkrahjes së vazhdueshme të kryengritjes në viset veriore shqiptare kundër Perandorisë Osmane. Sipas korrespondencës së brendshme zyrtare greke, kryengritjet në veri dobësonin forcën ushtarake osmane, shtonin urrejtjen e shqiptarëve ndaj turqve duke modeluar kështu ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve myslimanë dhe mbajtur të pashuar interesin e Evropës për Shqipërinë<sup>14</sup>. Për Athinën konsiderohej e udhës dhe më praktike që kryengritja e shqiptarëve duhej të kufizohej vetëm në sigurimin e privilegjeve që shqiptarët kishin gëzuar më parë, sesa në shfaqjen e prirjeve autonomiste<sup>15</sup>.

Në mbështetje të programit të saj për forcimin e lidhjeve miqësore me shqiptarët, të destinuar që në një të ardhme të afërt të luanin një rol të rëndësishëm në Perandorinë Osmane, qeveria greke shpejtoi që në krye të herës të merrte disa masa, të cilat konsistonin në:

1. Themelimin e një katedre të gjuhës shqipe në Universitetin Kombëtar, në bazë të një projektligji për universitetet që pritej të votohej në parlamentin grek brenda muajit qershor të vitit 1911.

2. Mësimin e shqipes si gjuhë e huaj në shkollat greke të Shqipërisë.

3. Botimin dhe shpërndarjen falas të teksteve të nevojshme shkollore.

4. Arsimimin me shpenzimet e qeverisë greke në një prej liceve grekë të një numri nxënësish shqiptarë myslimanë.

5. Strehimin dhe mbështetjen për refugjatët shqiptarë në Greqi si dhe ndihmë ekonomike për prijësit shqiptarë të mërguar në Malin e Zi.

6. Botimin e gazetës shqiptare “Shkreptima” në Kajro, në përkrahje të të drejtave shqiptare dhe të lidhjeve greko-shqiptare<sup>16</sup>.

Në zbatim të kësaj politike konsulli grek i Manastirit, Mavronidis hyri në kontakte me qarqet drejtuese shqiptare. Duke u shpjeguar kursin e

<sup>14</sup> *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και Ελληνοαλβανικές Σχέσεις* (Grekët e Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet greko-shqiptare) Επιμέλεια: Βασίλειος Κόντης (nën kujdesin e Vasil Kondis) Έγγραφα από το Ιστορικό Αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών. (Dokumenta nga Arkivi Historik i Ministrisë së Jashtme) Τόμος Ι, 1897-1918 (Vëllimi I, 1897-1918) Εστιασ: Αθήνα, 2004, f. 237-239, Raport i Sakturisë për ministrin e Jashtëm, Venizelos, Dhjetor 1911.

<sup>15</sup> *Po aty*, f. 203-204, Ambasada e Stambollit për Ministrinë e Jashtme të Greqisë, Stamboll, 22 maj 1911.

<sup>16</sup> Vasil Kondis, *Greqia dhe Shqipëria në shekullin XX*, Paratiritis: Selanik, 1997, f. 148, Shtojcë dokumentesh, Raport i Ministrisë së Jashtme Greke për konsullatat e Epirit dhe të Shqipërisë, Athinë, 30 qershor 1911.

politikës greke për të përkrahur përpjekjet kulturore e kombëtare të shqiptarëve dhe për t'i dhënë rëndësinë e duhur marrëdhënieve miqësore me ta, ai kërkoi bashkëpunimin e tyre<sup>17</sup>. Premtime u bënë edhe për mbështetje karshi hapjes së shkollave shqipe dhe përdorimit të shqipes në shkollat greke. Në këtë frymë, Leonidha Naçi, ish mësues i gjuhës shqipe në Korçë pasi mori në Athinë diplomën e nevojshme për ushtrimin e profesionit të mësuesisë u emërua me dekret mbretëror mësues i gjuhës shqipe në shkollën tregtare greke të Korfuzit. Hapja e një kursi për mësimin e gjuhës shqipe në Korfuz, sidomos në rrethanat kur Porta e Lartë nxirrte pengesa për ngritjen e shkollave kombëtare në Shqipërinë jugore, ishte një manifestim joshjeje në adresë të patriotëve shqiptarë. Qëllimeve të tilla propagandistike i shërbenin edhe bursat në gjimnazin e Vlahos në Korfuz që qeveria greke dha për katër shqiptarë nga Jugu<sup>18</sup>.

Në lidhje me aspektin e dytë të programit të qeverisë greke, atë të forcimit dhe përkrahjes së Kryengritjes në viset veriore, nënkonsulli grek i Durrësit, Th. Apostolopoulos në fillim të prillit 1911 u autorizua nga Athina për të shkuar provizorisht në Shkodër, një qytet ky tejet afër me zonën aktive të Kryengritjes. Më 25 prill, Ministria e Jashtme greke i dërgoi konsullatave në Janinë, Gjirokastër, Prevezë e Manastir, një udhëzim sipas të cilit u kërkohet nëpunësve konsullorë grekë që të tregonin mirëkuptim dhe të përkrahnin lëvizjen kryengritëse të shqiptarëve në Veri<sup>19</sup>. Në mbështetje të kësaj politike, nënkoloneli arvanitas Kondulis mbërriti në Çetinë ku dërgoi 25.000 franga dhe disa arka me armë e municion për kryengritësit malësorë<sup>20</sup>. Prej aty, ai informoi gjerësisht dhe në mënyrë të vazhdueshme qeverinë greke në lidhje me kryengritjen e shqiptarëve, reagimin e konsujve të Fuqive të Mëdha, qëndrimin e Malit të Zi dhe mbi të gjitha lëvizjet e faktorit politik shqiptar, siç ishte rasti i Ismail Qemalit. Ndërkohë që, nga Korfuzi dhe Himara, kjo e fundit një zonë larg syrit të vëzhgimit osman, në mënyrë

<sup>17</sup> *HHS.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 21-18-1824, Raport i konsullit të A-H në Manastir për Ministrinë e Jashtme, Manastir 20 janar 1911; *Po aty*, Vj. 21-18-1861, Raport i konsullit të A-H në Manastir për Ministrinë e Jashtme, Manastir, 9 korrik 1911.

<sup>18</sup> *Po aty*, Vj. 21-19-1980, Raport nga konsulli austro-hungarez në Korfuz për ministrin e Jashtëm, Korfuz, 22 gusht 1911.

<sup>19</sup> *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου...*, f. 200-201, Ministria e Jashtme për konsullatat e Janinës, Gjirokastrës, Prevezës dhe Manastirit, Athinë, 25 prill 1911.

<sup>20</sup> *HHS.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 21-18-1861, Raport i konsullit të Austro-Hungarisë në Manastir për Ministrinë e Jashtme, Manastir, 9 korrik 1911.

masive u futën armë për kryengritësit<sup>21</sup>. Po ashtu, në territorin grek u strehuan nacionalistë shqiptarë, një traditë kjo tek e cila Greqia ishte mbështetur qoftë për të fituar për vete shqiptarët qoftë për të ushtruar me anë të tyre një presion mbi qeverinë turke në çështje të tjera<sup>22</sup>.

Por, kjo ishte vetëm njëra anë e politikës greke ndaj çështjes shqiptare dhe e udhëzimeve që vinin nga Athina zyrtare. Në qarkoren e datës 25 prill 1911, të përmendur më sipër, Ministria e Jashtme urdhëronte prerazi nëpunësit e saj konsullorë se duhej të përpiqeshin që lëvizja të mbetej brenda zonave të pastra shqiptare dhe të mos zgjerohej në Jug. Po ashtu, ata duhet “t’u shpjegojnë banorëve homogjenë të zonave të tyre se zgjerimi i kryengritjes shqiptare përbën rrezik për interesat kombëtare të Greqisë dhe t’u sugjerojnë që të distancohen nga çdo lëvizje apo trazirë që vjen si pasojë e kryengritjes”<sup>23</sup>. Nëpunësit duhej t’i bindeshin pa asnjë shmangie udhëzimeve të qarkores duke mos dhënë asnjë ndihmë për përhapjen e kryengritjes në Jug.

Në momentin kur çështja shqiptare do të dilte nga kuadri i politikës së brendshme osmane duke marrë përmasa evropiane, ministri i Jashtëm grek, Joan Grispari (Joanis Grisparis) në një udhëzim të dytë në qershor të vitit 1911, i bënte me dije konsullatave greke në vilajetet e Rumelisë, se Greqia do të ndiqte më me interes ngjarjet në veri të kufirit të saj sepse asnjë zgjidhje e çështjes shqiptare nuk do të ishte e mundur pa cenuar sadopak interesat e larta greke. Pavarësisht se në korrespondencën e mësipërme, Greqia deklarohet e interesuar për themelimin e një shteti shqiptar, i cili konsiderohet si një “mik i singertë” dhe “aleat i domosdoshëm”, ajo nuk hezitonte të shprehej se “nuk do të pranonte asnjëherë zgjidhjen e çështjes shqiptare, në mënyrë të tillë, që të cenonte interesat e saj në Epir”<sup>24</sup>. Për Athinën zyrtare, politika mbi Epirin ishte plotësisht e caktuar me ruajtjen e karakterit thellësisht helen, që sipas saj,

<sup>21</sup> *Po aty*, Vj. 21-11-1113, Telegram nga sekretari i konsullatës austro-hungareze në Janinë për ministrin e Jashtëm, Janinë, 22 prill 1911.

<sup>22</sup> *Po aty*, Vj. 21-8-897, Raport nga konsullata e Austro-Hungarisë në Korfuz për ministrin e Jashtëm, Korfuz, 3 gusht 1911.

<sup>23</sup> *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου...*, f. 200-201, Ministria e Jashtme për konsullatat e Janinës, Gjirokastrës, Prevezës dhe Manastirit, Athinë, 25 prill 1911.

<sup>24</sup> V. Kondis, *Greqia dhe Shqipëria...*, f. 148, Shtojcë dokumentesh, Raport i Ministrisë së Jashtme Greke për konsullatat e Epirit dhe të Shqipërisë, Athinë, 30 qershor 1911.

atij i ishte njohur në mënyrë solemne nga Traktati i Berlinit<sup>25</sup>. Më 2 korrik 1911, udhëzimi i radhës bënte me dije se çdo veprim që synonte zgjerimin e lëvizjeve kryengritëse në Epir kishte për të hasur në kundërshtimin e qeverisë së Greqisë<sup>26</sup>.

Përpyekjet e shqiptarëve për përhapjen e lëvizjes kryengritëse në Jug, shqetësuan qeverinë greke, e cila i ndiqte me vëmendje zhvillimet aty. Në funksion të politikës së saj, ajo u përpoq ta mbante popullsinë ortodokse të vilajetit të Janinës sa më larg Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të intensifikonte procesin e helenizimit dhe njëkohësisht të veçonte çështjen e Epirit nga ajo shqiptare duke u përpyekur të ndalonte përhapjen e Kryengritje Shqiptare në territoret jugore. Në këtë drejtim vepruan intensivisht të gjithë nëpunësit konsullorë grekë.

Sakaq në korrik 1911, ajo përzuri nga territori grek, nacionalistët shqiptarë që ishin në përpyekje për të organizuar kryengritjen në viset jugore. Fazil Toptani, i cili nga maji i 1911 e kishte vendqëndrimin në Korfuz, me kërkesën e qeverisë greke u deportua nga aty<sup>27</sup>. Një urdhër i dytë për nxjerrjen jashtë veproi mbi Nikolla Ivanajn, njeriun e besueshëm të Komitetit Italo-Shqiptar, i cili nga Korfuzi mbante lidhje aktive me klube të ndryshme shqiptare në Shqipëri. Po ashtu ajo ndërpreu kontrabandën e armëve në drejtim të viseve shqiptare.

Me masat e marra, Greqia në mënyrë të qëllimshme pengoi përhapjen e kryengritjes në Shqipërinë e Poshtme. Këto nuanca të politikës greke u manifestuan hapur edhe në shtypin grek, i cili ndryshoi kryekëput shprehitë e tij. Ai nisi të lavdërojë qetësinë dhe paqen e të krishterëve “epirotë” duke i nxjerrë ata si shembull lojaliteti karshi osmanëve krahasuar me shqiptarët myslimanë. Po ashtu në faqet e tij nisën të shprehen ankesat mbi lëvizjet e shqiptarëve në Jug, të cilëve iu dha edhe vula e shtypësve të pandreqshëm të elementit të krishterë<sup>28</sup>.

<sup>25</sup> *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 21-17-1753, Korrespondenca e Agjencisë së Athinës, 9 korrik 1911 (Jepet në aneksin e relacionit nga Vlora, të datës 5 gusht 1911).

<sup>26</sup> *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου...*, f. 214-215, Ministria e Jashtme për Konsullatën në Vlorë, Athinë, 1 korrik 1911.

<sup>27</sup> *Po aty*.

<sup>28</sup> *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 21-8-897, Raport nga konsullata e Austro-Hungarisë në Korfuz për ministrin e Jashtëm, Korfuz, 3 gusht 1911.

Në përfundim mund të them se në kuadrin e Kryengritjes, aleanca mes shqiptarëve dhe grekëve rezultoi e pamundur. Pengesë e pakapërcyeshme për realizimin e saj mbetën pretendimet greke për territorin i Shqipërisë së Poshtme.